



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA EKONOMISË, KULTURES DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK ELBASAN**

Nr. 351.Prot

Elbasan më 12.05.2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në republikën e Shqipërisë “; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “, të Udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024 Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive së zhvillimit të Institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit,

Ofruesi publik i AFP-së Qendres së Formimit Profesional Publik Elbasan , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Specialist/e i Sektorit të Administrimit të Formimit Profesional

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme :

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryej detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale

- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk jan shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punes ne grup dhe te motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit te vendit te lire , duhet te perfshije.

- letermotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në)
- kartën e indentitetit
- diplomë
- librezë e punës
- çdo dukmentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në CV;
- çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim te gjendjes shendetesore
- vërtetimin te gjendjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka maaa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2.Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3.Dokumentet e aplikimit dorëzohen ne protokollin e ofrusit publik të AFP-së brënda datës 22.05.2025

